



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË

VENDIM

Nr. 113 Datë 14.12.2015

PËR MIRATIM E PËRDORIMIT TË FONDIT TRANZITOR PËR ZBATIMIN E REFORMËS ADMINISTRATIVO – TERRITORIALE NË VLERËN 39,917 MIJE LEKË ”

Këshilli i Bashkisë së Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë relacionin e paraqitur nga ekzekutivi, “Për miratim e përdorimit të fondit tranzitor për zbatimin e reformës Administrativo-territoriale në vlerën 39,917 mijë lekë”, duke u bazuar në ligjin nr. 8652 dt.31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”, neni 32, pika dh, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 160/2014 datë 27.11.2014 “Për buxhetin e vitit 2015”, në udhëzimin plotësues nr. 2 datë 09.01.2015 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015”, në udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2012 i MF “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, VKB nr. 16 datë 13.03.2015 mbi “Miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2015, VKB nr. 76 dt. 13.8.2015 “Mbi miratimin e projekt - buxhetit të Bashkisë së re Korçë për vitin 2015” si dhe në VKM nr. 664 datë 29.7.2015 “Për shpërndarjen e fondit tranzitor për zbatimin e reformës administrativo – territoriale”, në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të anëtarëve

VENDOSI :

1. Të miratojë përdorimin e fondit tranzitor në vlerën 39,917 mijë lekë të detajuar si më poshtë:
 - 1.1 Për shlyerjen e detyrimeve të Njësive Administrative në vlerën **6,735,439 lekë** e cila jepet në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Njësia Administrative	Shp për paga 600	Shp operative 602	Transferta tek org 604	Studime, projektme 230	Investime në arsimit 231/09120	Inv në infrastrukturën rrugore 231/04530	Total
1	Bulgarec		94,504					94,504
2	Voskop	39,960	3,687,164	230,314	238,400	552,000		4,747,838
3	Voskopojë						394,800	394,800
4	Drenovë		281,297					281,297
5	Lekas		881,000				336,000	1,217,000
	Total	39,960	4,943,965	230,314	238,400	552,000	730,800	6,735,439

Me këtë strukturë buxhetore:

00 01110 05	Art.	6000000	39,960 lekë (Bashkia)
00 01110 05	Art.	6020000	4,943,965 lekë ""
00 01110 05	Art.	6040000	230,314 lekë ""
00 01110 05	Art.	2300000	238,400 lekë ""
00 09120 05	Art.	2310000	552,000 lekë ""
00 04530 05	Art.	2310000	730,800 lekë ""

Detajimi i shpenzimeve të mësipërme sipas programeve do të bëhet me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

1.2. Për realizimin e disa investimeve emergjente si dhe investime të tjera të domosdoshme në programin e infrastrukturës rrugore për Njësitë Administrative në vlerën 30,671,481 lekë me këtë strukturë buxhetore:

00 04530 05 Art. 2310000 30,671,481 lekë (NSHP)

Detajimi i investimeve me objekte në infrastrukturën rrugore do të bëhet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.


1.3. Për blerjen e një sasive karburanti (naftë) në vlerën 2,510,080 lekë (15,688 litra naftë) e cila do të përdoret për pastrimin e kanaleve kulluese dhe veprave të ujrave të larta të cilat rrezikojnë përmbajtje të fshatrave dhe tokave në Njësitë Administrative dhe për pastrimin e rrugëve nga dëbora si dhe zhbllokime të rrugëve nga rrëshqitjet (raste emergjence) në njësitë administrative me këtë strukturë buxhetore:

00 06260 05 Art. 6020000 2,510,080 (NSHP)

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Financës dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR
ILIR BAJLOS**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E QYTETIT
KORÇË

RELACION

PËR MIRATIM E PËRDORIMIT TË FONDIT TRANZITOR PËR ZBATIMIN E REFORMËS ADMINISTRATIVO – TERRITORIALE NË VLERËN 39,917 MIJË LEKË ”

Në zbatim të ligjit nr. 160/2014 datë 27.11.2014 “Për buxhetin e vitit 2015”, të udhëzimit plotësues nr. 2 datë 09.01.2015 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015”, të udhëzimit nr. 2 datë 06.02.2012 i MF “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, si dhe të VKM nr. 664 datë 29.7.2015 “Për shpërndarjen e fondit tranzitor për zbatimin e reformës administrativo – territoriale” është akorduar fondi prej 39,917 mijë lekë për Bashkinë Korçë. Ky fond do të përdoret si më poshtë:

1. Për shlyerjen e detyrimeve të Njësive Administrative në vlerën 6,735,439 lekë, e cila jepet në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Njësia Administrative	Shp për paga 600	Shp operative 602	Transferta tek org 604	Studime, projekte 230	Investime në arsim 231/09120	Inv në infrastrukturën rrugore 231/04530	Total
1	Bulgarec		94,504					94,504
2	Voskop	39,960	3,687,164	230,314	238,400	552,000		4,747,838
3	Voskopojë						394,800	394,800
4	Drenovë		281,297					281,297
5	Lekas		881,000				336,000	1,217,000
	Total	39,960	4,943,965	230,314	238,400	552,000	730,800	6,735,439

Me këtë strukturë buxhetore:

00	01110	05	Art.	6000000	39,960 lekë (Bashkia)
00	01110	05	Art.	6020000	4,943,965 lekë “”
00	01110	05	Art.	6040000	230,314 lekë “”
00	01110	05	Art.	2300000	238,400 lekë “”
00	09120	05	Art.	2310000	552,000 lekë “”
00	04530	05	Art.	2310000	730,800 lekë “”

Detajimi i shpenzimeve të mësipërme sipas programeve do të bëhet me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

2. Për realizimin e disa investimeve emergjente si dhe investime të tjera të domosdoshme, në programin e infrastrukturës rrugore për Njësitet Administrative në vlerën 30,671,481 lekë me këtë strukturë buxhetore:

00 04530 05 Art. 2310000 30,671,481 lekë (NSHP)

Detajimi i investimeve me objekte në programin e infrastrukturës rrugore do të bëhet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

3. Për blerjen e një sasive karburanti (naftë) në vlerën 2,510,080 lekë (15,688 litra naftë) me këtë strukturë buxhetore

00 06260 05 Art. 6020000 2,510,080 (NSHP)

Kjo sasi karburanti do të përdoret për pastrimin e kanaleve kulluese dhe veprave të ujrave të larta të cilat rrezikojnë përmytje të fshatrave dhe tokave në Njësitë Administrative. Ky proces do të realizohet duke përdorur mjetet e Bordit të Kullimit. Nga përllogaritjet e bëra nevojiten

-Volumi i pastrimit do të jetë 34,000 m²,

-Ditë pune efektive 34 ditë

-Orë pune do të jenë (34 ditë x 6 orë/pune efektive) = 204 orë,

-Litra naftë/orë pune 22 litra

-Litra naftë gjithsej 4,488 litra

-Naftë për transport ekskavatori 1,200 litra (30 ditë x 40 litra)

-Naftë totale: 5,688 litra

Gjithashtu për pastrimin e rrugëve nga dëborat si dhe zhblokime të rrugëve nga rrëshqitjet (raste emergjence) në njësitë administrative Drenovë, Mollaj dhe Vithkuq do të punohet me 2 fadroma dhe 1 ekskavator.

-Ditë pune efektive nga 15 dhjetor-15 mars do të llogariten 20 ditë ose 1/3 e gjithë ditëve të dimrit.

Fadroma nr. 1 do të punojë pjesën Floq – Vithkuq

Fadroma nr. 2 do të punojë pjesën fushore Drenovë– Mollaj

Naftë për fadromën Nr. 1 20 ditë të parashikuara x 100 litra/ditë = 2,000 litra

Naftë për fadromën Nr. 2 20 ditë të parashikuara x 100 litra/ditë = 2,000 litra

Gjithsej naftë për këto 3 njësi **4,000 litra.**

Në njësitë administrative Bulgarec, Voskop, Voskopojë (brenda fshatit) dhe Lekas do të punohet me 3 fadroma x 100 litra/ditë = 300 litra/ditë

300 litra/ditë x 20 ditë = **6,000 litra**

Pra totali i naftës për përballimin e emergjencave të dimrit në zonat rurale është **10,000 litra.**

Kërkesa për miratimin e përdorimit të fondit prej 39,917 mijë lekë bazohet në ligjin nr. 160/2014 datë 27.11.2014 “Për buxhetin e vitit 2015”, në udhëzimin plotësues nr. 2 datë 09.01.2015 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015”, në udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2012 i MF “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, VKB nr. 16 datë 13.03.2015 mbi “Miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2015, VKB nr. 76 dt. 13.8.2015 “Mbi miratimin e projekt - buxhetit të Bashkisë së re Korçë për vitin 2015” si dhe në VKM nr. 664 datë 29.7.2015 “Për shpërndarjen e fondit tranzitor për zbatimin e reformës administrativo – territoriale”.

D.P.K.ZH.T.
Zhaneta Lubonja

NSHP
Thanas TONA

Drejtorja Juridike
Anxhela Dishnica

Drejtorja e Financës
Valbona Ziko

KRYETARI I BASHKISË
SOTIRAQ FILO